



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: HISTORIA E ARKITEKTURËS SHQIPTARE

Pedagogu: PhD.c.Ogri Mane

Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)

Lloji i lëndës: Disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)

Programi i studimit: bachelor

Viti/Semestri: II/I

EKSTRAKT

Historia e arkitekturës Shqipëtare është e një nga lëndët themelore të ciklit të historisë së popullit shqiptar dhe ka për objekt kryesor studimin e prodhimit arkitekturor si shprehje supreme e kulturës dhe intelektit . Ajo trajton historinë nga fillimet deri në vitin 1912.

Cikli i leksioneve ndahet në 7 (shtatë) kapituj:**Kapitulli i I** trajton arkitekturën që prej fillimeve të saja e deri në shek. e VI p.e.s. periudhë kjo e rendit të bashkësisë primitive dhe fillimit të lindjes së skllavopronarisë. Në këtë kapitull trajtohen ndërtimet prehistorike : banesat, kodërvarret dhe fortifikimet, si pikënisje e një tradite ndërtimore që vazhdon në shekuj.

Kapitulli i II përfshin arkitekturën gjatë shek. V p.e.s. — II p.e.s. që përkon me perjudhën e lindjes dhe fuqizimit të qyteteve dhe shteteve skllavopronare Ilire dhe Epirotë. Në të shqyrtohet arkitektura e fortifikimeve të para në lidhje të ngushtë me fortifikimet pararendëse, urbanistika dhe banesa, ndërtimet shoqërore (tempuj, stadjume, teatro, ndërtime sepulkrale) dhe së fundi ndërtimet inxhinjrike. **Kapitulli i III** trajton arkitekturën gjatë shek. I p.e.s. - VI e.s. gjatë periudhës së sundimit romak dhe bizantin të hershëm. Arkitektura e kësaj perjudhe, fortifikimet, ndërtimet shoqërore dhe ndërtimet inxhinjrike, shihen në vazhdimësi dhe në lidhje të ngushtë me traditën e pasur të arkitekturës së periudhës së mëparëshme, por njëkohësisht dhe si refleks të fenomeneve të reja shoqërore, shtimit të kryengritjeve dhe futjes së fesë së re kristjanizmit, si ideologji e pushtetit qëndror të perandorisë Romake, e cila pasqyrohet me lindjen e ndërtimeve paleokristiane. **Kapitulli i IV** përfshin arkitekturën gjatë shekujve VII-XV që përkon me periudhën e lindjes së formacioneve feudale dhe shtetit shqiptar. **Kapitulli i V** përfshin arkitekturën që prej shek. XV deri në shek. XVIII. Ai trajton vecas urbanistikën e qytetit gjatë mesjetës së vonë, fortifikimet e kësaj periudhe, arkitekturën islamike, postbizantine dhe ndërtimet inxhinjrike. **Kapitulli VI** ka për objekt trajtimin e banesës popullore, në qytet dhe në fshat. **Kapitulli VII** ka për objekt trajtimin e strukturës urbane të disa qyteteve Shqiptare.

TEMAT:

- LEKSION 1.** Arkitektura që prej fillimeve të saja e deri në shek. e VI p.e.s..
- LEKSION 2.** Arkitektura gjatë shek. V p.e.s. — II p.e.s..
- LEKSION 3.** Arkitektura e poliseve dhe e qyteteve koloni.
- LEKSION 4.** Arkitektura gjatë shek. I p.e.s. - VI e.s. gjatë periudhës së sundimit romak.
- LEKSION 5.** Arkitektura gjatë shek. I p.e.s. - VI e.s. gjatë periudhës së bizantin të hershëm.
- LEKSION 6.** Arkitektura e kultit kristian IV-VI.
- LEKSION 7.** Arkitektura gjatë shekujve VII-XV.
- LEKSION 8.** Arkitektura e kultit kristian VII-XV.
- LEKSION 9.** Arkitektura që prej shek. XV deri në shek. XVIII.
- LEKSION 10.** Arkitektura islamike shek. XV deri në shek. XVIII.
- LEKSION 11.** Arkitektura e banesës popullore, në qytet dhe në fshat.
- LEKSION 12.** Arkitektura e banesës popullore në fshat.
- LEKSION 13.** Struktura urbane e disa qyteteve Shqiptare.
- LEKSION 14.** Ansamblet tregtare dhe sociale të disa qyteteve Shqiptare.
- LEKSION 15.** Trashëgimia e arkitekturës shqiptare.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i dy tekseve apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e dy ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjeshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. *Historia e arkitekturës Shqiptare (nga fillimet deri në V.1912)*. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Instituti i Monumenteve të Kulturës. Autorë – A. Bace, A.Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo. Tiranë 1980. Maket
2. Revista shkencore “ Monumentet” , Botim i IMK
3. *Storia della citta’. I, II, III, IV*. Leonardo Benevolo, Laterza Editore, Roma 2006.
4. *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare, shek XV-XIX*. Autor, Emin Riza. Shtëpia Botuese “Dita 2000”. Tiranë 2009.
5. *Arkitektura e kishave të Shqipërisë, shek. VII- XV*. Autor, Aleksandër Meksi. Shtëpia Botuese “EUGEN”. Tiranë 2004.
6. *Pesë mijë vjet Fortifikime në Shqipëri*. Autor, Gjerak Karaiskaj. Shtëpia Botuese “8 NËNTORI”. Tiranë 1981.
7. Broshura të ndryshme të dhëna nga pedagogu i lëndës.